

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses-propozuesit të sigurimit N.T.P “[F...]” me seli në Skenderaj, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati “[I.S]” nga Prishtina, kundër të paditurit-kundërshtarit të sigurimit “[P...]” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati “[G.P]” nga Prishtina, për kthim të sendit, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.33/2019 e datës 21/02/2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **19/04/2019**, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pa themeltë ankesa e propozuesit të sigurimit N.T.P “[F...]” me seli në Skenderaj, ndërsa **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.33/2019 e datës 21/02/2019.

### **A r s y e t i m**

Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar EK.nr.33/19 e datës 21/02/2019, ka vendosur që të refuzon ne tërësi si të pa bazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurisë N.T.P “[F...]” me seli në Skenderaj, i paraqitur kundër kundërshtarit të sigurimit “[P...]” me seli në Prishtinë, që i referohet propozimit për ndalimin e shitjes apo tjetërsimin e ngastrave kadastrale nr..... dhe ..... të inicuar nga kundërshtari i sigurimit në procedurën përmbartimore, ndërsa sa i përket pikës II të dispozitivit mbi shpenzimet sigurimore secila pale ndërgjyqese i bart veç e veç.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur propozuesi i masës së sigurisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo te plote të gjendjes faktike, zbatimit te gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, të aprovoj ankesën e paditëses si të bazuar dhe të ndryshon aktvendimin e atakuar dhe çështjen të kthej në rigjykim.

I padituri-kundërshtari i sigurimit në afatin ligjore ka paraqitur përgjigje në ankesë, dhe i ka propozuar Gjykatës së Apelit aktvendimin i shkallës parë ta

vërtetoje dhe ankesën e paditësit-propozuesit të sigurisë ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

**-Ankesa është e pa themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi i sigurimit N.T.P “[F...]” me seli në Skenderaj, pran Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, më datën 25/01/2019 ka ushtruar padi, me kërkesë për caktimin masën se përkohshme të sigurisë, kundër paditurit-kundërshtarit të sigurimit “[P...]” me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar ndalimin e shitjes apo tjetërsimin e patundshmërive të ngastrave ..... dhe ..... të inicuar nga kundërshtari i sigurimit në procedurën përmbartimore si dhe ka kërkuar që nga e paditura/kundërshtari i sigurimit që shpenzimet e procedurës që do të krijohen gjatë procedurës gjyqësore t’ia paguaj paditësit/propozuesit të sigurisë. Nga arsyetimi i padisë-propozimit për caktimin e masës së sigurisë, pretendohet se paditësi-propozuesi i masës së sigurisë ka lidhur Kontratë e kredisë, me “[P...]” me seli në Prishtinë, me të cilën raport juridik kanë paraparë se paditësi-propozuesi i masës do të financon blerjen e makinerisë gurthyesit “[T...]” dhe gurthyesin “[T2..]” dhe do të jetë pronar deri sa pala tjetër kontraktuese-lizing-marrësi, ti kryej të gjitha pagesat e në ndërkohë këto pajisje janë transferuar në Kosovë dhe të njëjtat gjenden në posedimin e të paditurës.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ka mbajtur seancën dëgjimore dhe ndërgjyqësit i kanë paraqitur pretendimet e tyre sa i përket bazueshmërisë së propozimit, dhe pas përfundimit të seancës gjyqësore, ka marr aktvendimin e atakuar duke u bazuar në dispozitën e nenit 297 par.1 të LPK-së dhe duke e arsyetuar aktvendimin se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, me një kujdes të shtuar i ka analizuar pretendimet ankimore të propozuesit të sigurimit në raport me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe erdh në përfundim se të njëjtat tani për tani nuk mundë të qëndrojnë sepse masa siguroese është mjet për parandalimin e ndryshimit të gjendjes ekzistuese të kërkesëpadsisë dhe kjo masë mund të caktohet po që se propozuesi i masës e bënë të besueshme të drejtën e tij subjektive dhe paraqet prova apo rrethana që e bindin gjykatën se pa caktimin e masës se sigurisë ekziston rreziku serioz se kundërshtari i sigurimit me veprimin apo mos veprimin e tij mund t'ia pamundëson apo vështirëson dukshëm realizimin e kërkesëpadsisë. Në rastin konkret propozuesi i masës së sigurimit nuk ka ofruar ndonjë provë konkrete se kundërshtari i sigurimit vërtet mund të pamundësoj apo vështirësoj dukshëm realizimin e kërkesëpadsisë në ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do mund të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit, ndërsa nga shkresat e lëndës rezulton se kundërshtari i sigurimit N.T.SH. “[A...]” me seli në Podujevë, tani për tani e posedon një punë juridike të vlefshme-Kontrate të noterizuar për shitblerjen e makinerisë, që janë objekt shqyrtimi, me subjektin “[A2..]”, e cila kjo e fundit nuk është palë kontraktuese me paditësen “[R...]”, me seli në Beograd-Serbi, sipas Kontratës së Lezingut.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njëjta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nuk janë përmbushur konditat ligjore të parapara me dispozitën e nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**-Departamenti për Çështje Ekonomike-**  
**Ae.nr.98/19, me datën 19/04/2019**

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari  
Liridon Maloku, d.v